



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 10
23.07.2013

NR. VENDIMI 7
24.07.2013

V E N D I M
“PËR SEKUESTRIM PASURIE”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda e përbërë prej ;

Idriz MULKURTI – G J Y Q T A R

Asistuar nga sekretare Valbona Demiraj, ne Tiranë sot me dt.24.07.2013, ora 11.00, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën penale Nr.10 Akti që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar nga prokurori Olsian Çela.

ME OBJEKT:

- Sekuestrimin e pasurisë Nr.xxx, zona kadastrale xxx, me sipërfaqe trualli xxx metër katror, në lagjen “xxx” xxx në pronësi të shtetases A.Rr., banuese në xxx.
- Për administrimin e kësaj pasurie të ngarkohet një administrator pranë agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së financave Tiranë.
- Për ekzekutimin e kësaj sekuestrore të ngarkohet Zyra e Përmbarimit Gjyqësor, xxx.
- Në përputhje me nenin 5 të Ligjit, pezullimin e ekzekutimit të sekuestros deri në marrjen e një vendimi përfundimtar në lidhje me sekuestron preventive të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxx.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr.10192 datë 03.12.2009 për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.

Gjykata në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kërkesës, pasi shqyrtoi aktet e dëgjoji prokurorin i cili në përfundim kërkoi sipas objektit:

V Ë R E N :

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me kërkesën e saj drejtuar gjykatës ka kërkuar si më poshtë:

-Sekuestrimin e pasurisë Nr.xxx, zona kadastrale xxx, me sipërfaqe trualli xxx metër katror, në lagjen “xxx” xxx.

-Për administrimin e kësaj pasurie të ngarkohet një administrator pranë agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së financave Tiranë.

-Për ekzekutimin e kësaj sekuestroje të ngarkohet Zyra e Përmbarimit Gjyqësor, xxx.

-Në përputhje me nenin 5 të Ligjit, pezullimin e ekzekutimit të sekuestros deri në marrjen e një vendimi përfundimtar në lidhje me sekuestron preventive të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxx.

Këtë kërkesë e ka bazuar në ligjin Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Nga aktet e shqyrtuara gjatë seancës gjyqësore ka rezultuar si më poshtë: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në bazë të akteve të dërguara nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx me relacionin e datës xxx, në funksion të procedimit penal Nr.xxx të vitit xxx, ka regjistruar procedimin pasuror Nr.xx të vitit xxx në ngarkim të shtetasit M.Rr. Nga studimi i akteve rezulton se ndaj këtij shtetasi Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx ka regjistruar procedim penal për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale” e parashikuar nga neni 287/1-a, b, dh të K.Penal.

Nga hetimet ka rezultuar se në datën xxx, me kontratën Nr.xxx Rep., Nr.xxx Kol., shtetasja A.Rr., e shoqja e të pandehurit M., ka blerë nga shtetasi A.A. një sipërfaqe trualli në lagjen “xxx” në xxx, me sipërfaqe xxx metër katror, e regjistruar me numrin xxx në zonën kadastrale Nr.xxx. Çmimi i blerjes ka qënë xxx lekë, ndërkohë që vetë shitësi A.A., e ka blerë këtë truall në datën xxx për çmimin xxx lekë. Shitësi ka qënë shtetasja Xh.A., e cila ka vepruar mbi bazën e një prokure të dhënë nga J. dhe M.A., pronarët e këtij trualli mbi bazë të një vendimi të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave xxx, datë xxx. Nga hetimet e kryera ka rezultuar se vendimi i KKKP, i dorëzuar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në xxx për regjistrimin e pronësisë, është i fallsifikuar. Kopja e vendimi Nr.xx, datë xxx, të administruar nga AKKP xxx, është i ndryshëm në formë dhe përmbajtje nga ai i përdorur për regjistrimin

e pronës. Sipas këtij vendimi, M.A., është njohur si pronar në një sipërfaqe prej xxx metër katror në rrugën “xxx”. Sipas deklarimeve të të pandehurës Xh.A., bashkëshorti i saj ka pasur njohje me M. dhe ky i fundit i ka premtuar që do ta ndihmonte për regjistrimin e pronës në ZRPP xxx. Për ndihmën e dhënë i pandehuri M. do të bëhej bashkëpronar në pasurinë që do të regjistrohej. Në fakt, gjatë kontrollit të banesës së të pandehurit M., është gjetur një kopje e vendimit origjinal të KKKP xxx, e cila nuk përputhet me atë të dorëzuar në ZRPP për regjistrimin e pronës, çka tregon për dijeninë dhe përfshirjen e tij të plotë në këtë veprimtari të kundërligjshme.

Pasi është bërë pronare, rezulton se shtetasja A.Rr. ka filluar një investim sipërmarrje për ndërtim pallati me firmën xxx sh.p.k në datën xxx.

Në datën xxx, Gjykata ë Rrethit Gjyqësor xxx me vendimin Nr.xxx, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive” ndaj pasurisë Nr.xxx, zona kadastrale xxx, me sipërfaqe “fallsifim të dokumentave”. Nga hetimi pasuror i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx nuk ka rezultuar se i pandehuri apo e shoqja e tij të disponojnë vlera monetare të cilat të kenë origjinë të ligjshme. Vlera prej xx xxx lekësh e përdorur për blerjen e truallit në fjalë (nëse është paguar në fakt, pasi nga hetimi rezulton që tjetërsimi i pronës të jetë bërë si rrjedhojë e një marrëveshje të mëparshme kundrejt ndihmës që ka dhënë i pandehuri për regjistrimin e pronës) rezulton të vijë prej një tjetër veprimi kriminal i cili lidhet me tjetërsimin e disa pronave që kanë qënë në pronësi të nënës së të pandehurit, K.Rr. Konkretisht i pandehuri ka përfituar në datën xxx shumën xxx lekë për shitjen e pasurisë Nr.xxx, zona kadastrale xxx, lloji kullotë, me sipërfaqe xxx metër katror si dhe shumën xxx lekë për shitjen e pasurisë Nr.xxx, zona kadastrale Nr.xxx, e llojit kullotë, me sipërfaqe xxx metër katror. Nga hetimet ka rezultuar se këto prona janë fituar nga e ëma e të pandehurit përmes fallsifikimit që ky i ka bërë vendimit të KKKP xxx, Nr.xxx, datë xxx. Blerësi i këtyre pronave, Dh.K. i ka shitur ato sërish tek shtetasi A.N. në datën xxx.

Një fakt të tillë prokurori e provoi në seancë me aktet si më poshtë:

- Urdhër për regjistrimin e procedimit pasuror datë xxx.

- Shkresë Nr.xxx Prot., datë xxx, e Prokurorisë së Rrehit Gjyqësor, xxx.
- Lista e akteve, gjithësej xxx fletë, e Prokurorisë së Rrehit Gjyqësor, xxx.
- Urdhër për regjistrimin e procedimit penal datë xxx.
- Vendim Nr.xxx datë xxx, i Gjykatës së Rrehit Gjyqësor, xxx.
- Urdhër për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale datë xxx.
- Vendim për marrjen e të pandehurit dhe njoftimin e akuzës, datë xxx.
- Vendim Nr.xxx datë xxx, i Gjykatës së Rrehit Gjyqësor, xxx.
- Vendim Nr.xxx datë xxx, i Gjykatës së Rrehit Gjyqësor, xxx.
- Shkresë Nr.xxx Prot. datë xxx, e Prokurorisë së Rrehit Gjyqësor, xxx.
- Shkresë Nr.xxx Prot., datë xxx, me lëndë: kthim përgjigje, bashkëngjitur saj kopje e dokumentacionit në bazë të së cilit është bërë regjistrimi i pasurisë me Nr.xxx; kopje e kartelës së pasurisë së paluajtshme, e Ministrisë së Drejtësisë, gjithësej 85 (tetëdhjetëepesë) fletë.

Gjykata në analizë të akteve të sipërcituara si dhe duke pasur parasysh kërkesat e neneve 3, 5, 11, 14, 15 24 të ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, çmon se duhet pranuar kërkesa e prokurorit për sekuestrimin e pasurisë Nr.xxx, zona kadastrale xxx, me sipërfaqe trualli xxx metër katror, në lagjen “xxx”-xxx në pronësi të shtetas A.Rr. për sa më poshtë:

Së pari: Shtetasja A.Rr. në pronësi të cilës është kjo sipërfaqe trualli është bashkëshorte e të pandehurit M.Rr. dhe hyn në subjektet që parashikon neni 2/a i ligjit nr 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Së dyti: Provohet se pasuria në mënyrë të tërthortë zotohet nga i pandehuri sipas parashikimit të nenit 24 të ligjit sipërcituar.

Së treti: Ka indicie që kjo pasuri është produkt i një vepre penale por dhe në rast blerje reale shuma e përdorur rrjedh nga një tjetër vepër penale, pasi subjektet nuk rezulton që të kenë të ardhura për të justifikuar blerjen.

Së katërti: Ekziston një rrezik real që pasuria në fjalë të tjetërsohet në rast

të shfuqizimit të sekuestros preventive vendosur ne funksion të procedimit penal pasi A.Rr. bashkëshortia e të pandehurit mund të kryejë veprime juridike si pronare e pasurisë

Lidhur me ekzekutimin e këtij vendimi gjykata çmon të ngarkojë zyrën e përmbarrimit të rrethit xxx, meqënëse pasuria është në juridiksionin e atij rrethi, ndërsa për administrimin dhe përdorimin e pasurive z.S.K., i cili është administrator në Agjensinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave. Po kështu gjykata në përputhje me nenin 5 të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, çmon se duhet vendosur pezullimi i ekzekutimit të sekuestros deri në marrjen e një vendimi përfundimtar në lidhje me sekuestron preventive të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxx.

Sa sipër gjen mbështetje në shpjegimet e prokurorit, në aktet e paraqitura nga ana e tij në seancë të cilat ju nënshtruan shqyrtimit gjyqësor si dhe në ligjin Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

PËR KËTO ARSYE :

Gjykata bazuar në nenet 3, 5, 11, 12, 14, 15 te ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”,

V E N D O S I:

-Pranimin e kërkesës:

-Sekuestrimin e pasurisë Nr.xxx, zona kadastrale xxx, me sipërfaqe truallit xxx m² që ndodhet në lagjen “xxx” xxx në pronësi të shtetases A.Rr.

-Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet zyra e përmbarrimit të rrethit xxx, ndërsa për administrimin dhe përdorimin e pasurive z.S.K., i cili është administrator në Agjensinë për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të Sekuestruara dhe të konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

-Pezullimin e ekzekutimit të sekuestros deri në marrjen e një vendimi përfundimtar në lidhje me sekuestron preventive të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor xxx.

-Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda afatit ligjor në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

U shpall sot me datë 24.07.2013, ora 11.20

S E K R E T A R E

G J Y Q T A R

Valbona DEMIRAJ

Idriz MULKURTI